



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA LEZHE**

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Lezhë, më \_\_\_\_/\_\_\_\_/2022

**Shtojca 11**

[Shtojcë për tu plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

**FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT**

Data 06/06/2022

Drejtuar: Operatorit Ekonomik “Entoni Prenga” P/F, me adrese Lagjja “IVANAJ”, Rruga Lezhe - Tirane km 1, Godine 1 kateshe ne pronen me nr. 180/163, ZK nr. 1987, Shengjin, Lezhe.

Procedura e prokurimit/lotit: E Hapur/ Sherbime.

Numri i procedurës/referenca e Lotit: REF-28044-05-09-2022

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: “Sherbimi i mirembatjes dhe riparimit te automjeteve dhe mjeteve te renda per vitin 2022”.

Kohëzgjatja e kontratës: 12 Muaj nga data e nenshkrimit te Marreveshjes Kuader.

Publikimet e mëparshme (nëse është rasti): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në kosto

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim

Me anë të këtij Njoftimi ju informojmë se, në këtë procedurë kanë marrë pjesë Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

- 1- Operatori Ekonomik “ENTONI PRENGA” SH.P.K, me Nuis L58309521A, me oferte ekonomike 13,050,550 (trembedhete milion e pesedhete mije e peseqind e pesedhete) Lek pa TVSH
- 2- Operatori Ekonomik “LINDA 80” SH.P.K, me Nuis K37513530U, me oferte ekonomike 13,080,950 (trembedhete milion e tetedhete mije e nenteqind e pesedhete) Lek pa TVSH.
- 3- Operatori Ekonomik “SERDADO” SH.P.K, me Nuis J67902524E, me oferte ekonomike 12,765,000 (dymbedhete milion e shtateqind e gjashtedhete e pese mije) Leka pa TVSH.

Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:

I- Operatori Ekonomik “LINDA 80” SH.P.K me Nuis K37513530U,

Nga verifikimi i dokumentacionit ne SPE rezulton se OE:

**Se pari**, nuk ka paraqitur sigurimin e ofertes sipas shtojces 3,

KVO bazuar ne nenin 83, te ligjit nr.162/2020 “Per prokurimin publik”, parashikohet se: *1. Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël. Në rastin e kontratave sektoriale, enti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, ndërkohë që mund të kërkojë paraqitjen e këtij sigurimi edhe në procedurat nën kufirin e lartë monetar, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël.*

Si dhe ne nenin 30, te VKM-se 285, date 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, parashikohet se: *“1Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël, sikurse përcaktohet në nenin 83, të LPP-së. Enti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël, sikurse përcaktohet në nenin 83, të LPP-së. Enti kontraktor, sipas vlerësimit të tij, mund të kërkojë ose jo sigurim oferte për procedurat nën kufirin e lartë monetar. 2. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor pranon mundësinë e pagesës së vlerës së sigurimit, nga ofertuesi, në vlerë monetare në llogarinë e autoritetit/entit kontraktor. Përveç kësaj forme të paraqitjes së sigurimit të ofertës, sigurimi i ofertës mund të ketë formën e një depozite apo garancie, të lëshuar nga një bankë ose një shoqëri sigurimi, e licencuar nga shteti për të ushtruar këtë veprimtari”*,

Sa me siper KVO, vlereson se per te permbushur kete kriter OE-te duhet te paraqesin sigurimin e ofertës ne formën e një depozite apo garancie, të lëshuar nga një bankë ose një shoqëri sigurimi e cila duhet te jete e neshkruar nga Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimit.

Nga verifikimi i dokumentacionit ne SPE, rezulton se OE nuk ka ngarkuar ne SPE sigurimin e ofertes sipas shtojces 3, duke e bere te pa përmbushur kete kriter.

**Se dyti**, nuk ploteson kriterin 2.3.3, ku parashikohet se *“Operatori ekonomik duhet të disponojë për periudhen (Shkurt 2022-Mars 2022), punonjës të specializuar/të kualifikuar, si më poshtë:*

- 1 (nje) ing. Mekanik (Pergjegjes Teknik), i pajisur me diplome dhe Dëshmi së aftësisë profesionale të përgjegjësit teknik;
- 1 (nje) Punonjes Motorist-Xhenerik, i diplomuar per teknologji automobilash;
- 1 (nje) Mekanik Automjetesh i pajisur me certefikate/dëshmi, te leshuar nga Institucionet perkatese
- 1 (nje) Axhustator, te paisur me deshmi përkatëse;
- 2 (dy) Punonjes Sherbimi

*Për punonjësit e mësipërm perveq dokumentacionit te kerkuar mesiper duhet të paraqiten dhe kontrata e punës e vlefshme, Librezat e punes, si dhe të figurojnë në listëpagesat e shoqërisë për të paktën muajt Shkurt 2022-Mars 2022.*

---

*Shenim: Kjo kerkese permbushet nepermjet paraqitjes nga operatoret ekonomik te formularit permbledhes te vetedeklarimit sipas shtojces perkatese te DST-se dhe dokumentacioni i kerkuar duhet te paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar, i pari perpara publikimit te njoftimit te fituesit dhe fillimit te afatit te ankimimit.”*

KVO veren se bazuar ne piken 1, te nenit 26, te VKM-se nr. 285, date 19.05.2021 “Per miratimin e rregullave te prokurimit publik” i ndryshuar, parshikohet se: *Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetedeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla, dhe per te permbushur kete kriter operatoret ekonomik pjesmarres duhet te vetedeklarojne ne formularin permbledhes te vetedeklarimit sipas shtojces perkatese te DST-se, te dhenat e punonjës të specializuar/të kualifikuar qe disponon sipas percaktimeve te mesiperme.*

Nga verifikimi ne SPE, rezulton se ky OE nuk ka deklaruar ne formularin permbledhes te vetedeklarimit, disponimin e - 1 (nje) ing. Mekanik (Pergjegjes Teknik), i pajisur me diplome dhe Dëshmi së aftësisë profesionale të përgjegjësit teknik, 1 (nje) Punonjes Motorist-Xhenerik, i diplomuar per teknologji automobilash, 1 (nje) Mekanik Automjetesh i pajisur me certifikate/dëshmi, te leshuar nga Institucionet perkatese, 1 (nje) Axhustator, te paisur me deshmi përkatëse dhe 2 (dy) Punonjes Sherbimi duke mos permbushur kete kriter.

**Se treti**, nuk ploteson kriterin 2.3.4 ku parashikohet se “Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë ne pronesi, me qira ose kontrate bashkepunimi mjetet dhe pajisjet e mëposhtme:

**2.3.4/a** 3 (tre) vinca statik / ura ngritëse, te instaluara brenda ambjenteve te sevisit.

**2.3.4/b** 1 (nje) mjet “Karotrec”, per transportimin e mjeteve nga vendodhja ku ka ndodhur defekti, drejt servisit.

• Per te provuar disponimin e mjeteve te kerkuar ne pike 2.3.4/a, OE duhet te paraqesë fature tatimore blerjeje ne emër te tij ose kontrate qeraje/bashkepunimi te vlefshme per gjithë periudhën e kontratës si dhe foto. KVO rezervon te drejtën e verifikimit ne objekt te disponimit te urave ngritëse /vinçave.

• Per te provuar disponimin e mjetit te kerkuar ne pike 2.3.4/b, OE duhet te paraqese:

➤ Ne rast te disponimit te automjetit ne pronesi, duhet të paraqitet dokumentacioni që vertetojne pronesine e mjetit: - certifikaten e pronesise; -leja e qarkullimit; - siguracionin; - taksat vjetore.

➤ Ndersa per mjete te marra me qira/kontrate bashkepunimi krahas dokumentacionit te mesiperm, duhet te paraqitet edhe kontrata e qirase/ bashkëpunimit.

*Shenim: Kjo kerkese permbushet nepermjet paraqitjes nga operatoret ekonomik te formularit permbledhes te vetedeklarimit sipas shtojces perkatese te DST-se dhe dokumentacioni i kerkuar duhet te paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar, i pari perpara publikimit te njoftimit te fituesit dhe fillimit te afatit te ankimimit”.*

KVO veren se bazuar ne piken 1, te nenit 26, te VKM-se nr. 285, date 19.05.2021 “Per miratimin e rregullave te prokurimit publik” i ndryshuar, parshikohet se: *Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla, dhe për te përmbushur kete kriter operatorët ekonomik pjesmarres duhet te vetedeklarojne ne formularin përmbledhes te vetedeklarimit sipas shtojces perkatese te DST-se, te dhenat e mjeteve dhe pajisjeve, sipas percaktimeve te mesiperme.*

Nga verifikimi ne SPE, rezulton se ky OE nuk ka deklaruar ne formularin përmbledhes te vetedeklarimit, disponimin e mjeteve dhe pajisjeve, sipas pikes 2.3.4, te DST duke mos përmbushur kete kriter.

**Se katerti**, nuk ploteson kriterin 2.3.5 ku parashikohet se “*Operatori Ekonomik duhet te disponoje ne pronesi, me qera ose kontrate bashkepunimi, nje pike per larjen e Automjeteve (Lavazh).*

**a-** *Per te provuar kriterin e mesiperme OE duhet te paraqese kontrate qiraje/ Kontrate Bashkepunimi apo Çertifikata/Vertetim Pronesie,*

**b-** *Pika per larjen e Automjeteve (Lavazh), detyrimisht duhen te jete i pajisur me Çertifikate regjistrimi (QKB).*

*Shenim: Kjo kerkese përmbushet nepermjet paraqitjes nga operatorët ekonomik te formularit përmbledhes te vetedeklarimit sipas shtojces perkatese te DST-se dhe dokumentacioni i kerkuar duhet te paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar, i pari perpara publikimit te njoftimit te fituesit dhe fillimit te afatit te ankimimit”.*

KVO veren se bazuar ne piken 1, te nenit 26, te VKM-se nr. 285, date 19.05.2021 “Per miratimin e rregullave te prokurimit publik” i ndryshuar, parshikohet se: *Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla, dhe për te përmbushur kete kriter operatorët ekonomik pjesmarres duhet te vetedeklarojne ne formularin përmbledhes te vetedeklarimit sipas shtojces perkatese te DST-se, te dhenat e nje pike per larjen e Automjeteve (Lavazh) qe disponon.*

Nga verifikimi ne SPE, rezulton se ky OE nuk ka deklaruar ne formularin përmbledhes te vetedeklarimit, disponimin e nje pike per larjen e Automjeteve (Lavazh), sipas pikes 2.3.5 te DST duke mos përmbushur kete kriter.

**Se pesti**, nuk ploteson kriterin 2.3.6, 2.3.7, pasi Operatori Ekonomik nuk ka paraqitur asnje dokumentacion qe provon plotesimin e ketyre kriterëve.

Sa me siper Komisioni i Vleresimit te Ofertave mbeshtetur nenin 77, pika 1, 4 dhe 5, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet se: 1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe

---

profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës. 4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës. 5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve, si dhe në nenin 92, pika 3 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet: “Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji”, vendosi të refuzojë ofertën e OE “LINDA 80” SH.P.K, për mos përmbushje të kriterëve të vecanta kualifikuese.

**Si perfundim, në mbështetje të nenit 92, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, OE “LINDA 80” SH.P.K me Nuis K37513530U, skualifikohet.**

II- Operatori Ekonomik “SERDADO” SH.P.K me Nuis J67902524E,

Nga verifikimi i dokumentacionit në SPE rezulton se OE:

Se pari, nuk plotëson kriterin 2.1.1, pasi nuk ka paraqitur shtojcën 2, të formularit të ofertes (*Shtojcë për t’u paraqitur nga operatori ekonomik*).

KVO mban në konsideratë se në nenin 14, të VKM-se 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, parashikohet se: “*APP-ja harton dhe miraton me vendim formatin e dokumenteve standarde të tenderit që do të përdoren gjatë procedurave të prokurimit, për çdo lloj procedure prokurimi sipas nenit 41, të LPP-së, dhe çdo tip kontrate*”.

Po ashtu KVO konstaton se formati i “[Shtojcës 2. Listat e Çmimeve të Shërbimeve](#)” për procedurat e prokurimit “E hapur/ Shërbime” është miratuar me vendimin nr. 02, datë 09.06.2021 “*Për miratimin e dokumentave standarde të tenderit për mallra, punë, shërbime për procedurën e prokurimit “Procedure e Hapur” dhe asnjë autoritet kontraktor apo operator ekonomik nuk mund të modifikojë apo të ndryshojë formularët e miratuar në DST.*”

Gjithashtu në dokumentat standarde të tenderit të procedurave të prokurimit me objekt “Shërbimi i mirembajtjes dhe riparimit të automjeteve dhe mjeteve të renda për vitin 2022”, në seksionin I, udhëzime për Operatorët Ekonomike, në pikën B/4 përcaktohet se: “*Operatori Ekonomik paraqet*

---

*Formularin e Ofertës në përputhje me formularin e paraqitur në Seksionin II: **Të gjithë Formularët shoqëruës duhet të plotësohen pa ndonjë ndryshim**, nuk do të pranohet asnjë zëvendësues. Të gjitha vendet bosh duhet të plotësohen me informacionin e kërkuar”.*

Sa me sipër duke qenë se OE nuk ka paraqitur shtojcën 2, ky kriter konsiderohet i papërbushur. **Se dyti**, nuk plotëson kriterin 2.3.3, ku parashikohet se “Operatori ekonomik duhet të disponojë për periudhën (Shkurt 2022-Mars 2022), punonjës të specializuar/të kualifikuar, si më poshtë:

- 1 (nje) ing. Mekanik (Pergjegjes Teknik), i pajisur me diplome dhe Dëshmi së aftësisë profesionale të përgjegjësit teknik;
- 1 (nje) Punonjes Motorist-Xhenerik, i diplomuar për teknologji automobilash;
- 1 (nje) Mekanik Automjetesh i pajisur me certifikate/dëshmi, të leshuar nga Institucionet përkatëse
- 1 (nje) Axhustator, të paisur me dëshmi përkatëse;
- 2 (dy) Punonjes Sherbimi

*Për punonjësit e mësipërm përveç dokumentacionit të kërkuar më sipër duhet të paraqiten dhe kontrata e punës e vlefshme, Librezat e punës, si dhe të figurojnë në listëpagesat e shoqërisë për të paktën muajt Shkurt 2022-Mars 2022.*

*Shenim: Kjo kerkese përmbushet nepermjet paraqitjes nga operatorët ekonomik të formularit përmbledhës të vetedeklarimit sipas shtojcës përkatëse të DST-se dhe dokumentacioni i kërkuar duhet të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar, i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe fillimit të afatit të ankimimit.”*

I.KVO vëren se bazuar në piken 1, të nenit 26, të VKM-se nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet se: *Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetedeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla, dhe për të përmbushur këto kriter operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të vetedeklarojnë në formularin përmbledhës të vetedeklarimit sipas shtojcës përkatëse të DST-se, të dhënat e punonjës të specializuar/të kualifikuar që disponon sipas përcaktimeve të mësipërme.*

I. Nga verifikimi në SPE, vërehet se në përmbushje të kriterit 2.3.3, në formularin përmbledhës të vetedeklarimit OE “SERDADO” SH.P.K, ka deklaruar se: “*Profili i punonjesve*

*Ing. Mekanik (Pergjegjes Teknik) 1- Shaban Mera*

*Mekanik Automjetesh 1- Klaudio Mhilli*

*Ekonomiste 1- Sara Mhilli*

*Xhenerik 1- Aleksander Kraja*

*Motorist 1- Aurel Ndreca*

*Axhustator 1- Gezim Doda*

*Punonjes Sherbimi 2- Shqiponja Mhilli & Klinton Qerimi”*

II. Në vijim, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, me qëllim vlerësimit sa më objektiv të procedurës, i kërkoj informacion OE “SERDADO” SH.P.K lidhur me plotësimin e kriterit 2.3.3 të

---

DST, ne lidhje me disponimin e 1 (nje) Punonjes Motorist-Xhenerik, i diplomuar per teknologji automobilash, pasi ne formularin permeledhes te vetedeklarimit nuk eshte percaktuar cili nga personat e deklaruar ne formular disponon diplome universitare per teknologji automobilash.

KVO konsatoi se ne formularin permeledhes te vetedeklarimit eshte deklaruar *Xhenerik – Aleksander Kraja, Motorrist - Aurel ndreca*, por nuk eshte deklaruar cili prej ketyre te fundit disponon diplome universitare per teknologji automobilash dhe vendosi te kerkoje OE “SERDADO” SH.P.K, te paraqese ne Sistemin e Elektronik te Prokurimeve brenda ores 14:00, te dates 31.05.2022, numrin dhe daten e leshimit te Diplomes se Universitetit, si dhe emrin e Universitetit qe ka leshuar dokumentin per nje nga punonjesit e meposhtem:

*Xhenerik – Aleksander Kraja,*

*Motorrist - Aurel Ndreca*

III.Nga verifikimi ne SPE deri ne oren 15:00, te dates 01.06.2022, nuk rezulton qe OE “SERDADO” SH.P.K te kete paraqitur informacionin e kerkuar nga ana e KVO-se.

Sa me siper duke qene se OE nuk disponon nje Punonjes Motorist-Xhenerik, i diplomuar per teknologji automobilash, ky kriter konsiderohet i papermbushur.

Sa me siper Komisioni i Vleresimit te Ofertave mbeshtetur nenin 77, pika 1, 4 dhe 5, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet se: 1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës. 4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës. 5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve, si dhe në nenin 92, pika 3 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet: “Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji”, vendosi te refuzoje oferten e OE “SERDADO” SH.P.K, per mos permbushje te kriterëve te vecanta kualifikuese.

---

***Si perfundim, në mbështetje të nenit 92, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, OE “SERDADO” SH.P.K me Nuis J67902524E, skualifikohet.***

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë Operatorin Ekonomik “Entoni Prenga” P/F, me adrese Lagjja “IVANAJ”, Rruga Lezhe - Tirane km 1, Godine 1 kateshe ne pronen me nr. 180/163, ZK nr. 1987, Shengjin, Lezhe, se oferta e paraqitur me vlerë totale prej 13,050,550 (trembedhete milion e pesedhete mije e peseqind e pesedhete) Lek pa TVSH është identifikuar si Oferta e suksesshme.

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 109, të Ligjit Nr. 162/ 2020, datë 23.12.2020, “Për Prokurimin Publik”.

**TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR  
KRYETARI  
Pjerin NDREU**

---